



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr.23, Datë 19.02.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.02.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 597/1 prot., datë 14.02.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 597 prot., datë 07.02.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke kërkuar vijimësinë e procedurës së licencimit me procedurë të përshpejtuar, pasi kjo shoqëri (kompani bijë e Protergia Energy SA, me seli në Athinë të Greqisë), kërkon të regjistrohet në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX sh.a.), të themeluar në Shqipëri.
- Sa i përket kërkesës për procedurë të përshpejtuar në zbatim të nenit 37 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, sqarojmë se shoqëria nuk i plotëson këto kushte dhe ERE është e detyruar të procedojë në përputhje me dispozitat që rregullojnë procedurën e licencimit dhe nëse pas fillimit të procedurës dhe përfundimit të afatit të pritjes së komenteve, shoqëria do të ketë plotësuar të gjithë informacionin/dokumentacionin e munguar, do të ndiqet me përparësi vendimmarrja përfundimtare për këtë aplikim.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”, për pikën 1.3 gërmën “c”; si dhe pikën 2.5.
- Nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/informacion në vijim:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”:** Të depozitohen vërtetimet e gjendjes gjyqësore (dëshmitë e penalitetit), të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorët dhe vetë shoqërinë “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k.

#### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”:** Të depozitohet vërtetimi që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “b”:** Të depozitohen pasqyrat financiare për kohën e krijimit të shoqërisë, si dhe dokumentacion mbështetës për vlerën e mbetur për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë për të paktën 1 (një) muaj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**